



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/105


Datë: 19.08.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 gusht 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkripteve nga mbledhjet 94, 95, 96 dhe 97 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/105


Datë: 19.08.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 6 paragrafi 1. të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 gusht 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti për Gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës për vitin 2015.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Raportin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/105

Datë: 19.08.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 gusht 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Rregullimin e Funkcionimit të Organizatave Joqeveritare.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Ministria e Administratës Publike dhe institucionet tjera kompetente, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/105

Datë: 19.08.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 22A të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 gusht 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Lista e Projekteve për Financim përmes Klauzolës së Investimeve, sipas dokumentit të bashkëngjitur të këtij Vendimi.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Listën e aprovuar nga paragrafi 1. i këtij Vendimi t'ia përcjellë Kuvendit të Republikës së Kosovës për informim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/105

Datë: 19.08.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 gusht 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë 80.000 (tetëdhjetëmijë euro) për kategoritë e Luftës së UÇK-së, për qëllim rehabilitimi në pushime verore në bregdetin shqiptarë dhe në banja të Kosovës, si në vijim:
 - 1.1. Për Shoqatën e Invalidëve të Luftës së UÇK-së (ShILUÇK), për pushime verore në bregdetin shqiptarë për Invalidët e Luftës së UÇK-së, ndahen 50,000.00 (pesëdhjetë mijë euro) nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, kodi i programit 003 dhe barten në nr.e xhirollogarisë: 1110003683000163-ProCredit Bank, të ShILUÇK-së;
 - 1.2. Për Shoqatën e Invalidëve të Luftës së UÇK-së (ShILUÇK), për rehabilitimin në banjat e Kosovës ndahen 10,000.00 (dhjetë mijë euro) nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, kodi i programit 003 dhe barten në nr. e xhirollogarisë: 1110003683000163-ProCredit Bank, të ShILUÇK-së;
 - 1.3. Për Shoqatën e Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së (ShFDUÇK), për rehabilitimin në banjat e Kosovës ndahen 10,000.00(dhjetë mijë euro) nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, kodi i programit 003 dhe barten në nr. e xhirollogarisë: 1110270777000187-Pro Credit Bank, të ShFDUÇK.
 - 1.4. Për Shoqatën e Veteranëve të Luftës së UÇK-së (ShVLUÇK), për rehabilitimin në banjat e Kosovës ndahen 10,000.00 (dhjetë mijë) euro nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, kodi i programit 003 dhe barten në nr. e xhirollogarisë: 1701001010734491-NLB Bank, të ShVLUÇK-së.
2. Ndahen mjete financiare në vlerë 10.000.00 (dhjetëmijë euro), për Persona me Aftësi të Kufizuar për qëllim rehabilitimi në pushime verore në bregdetin shqiptarë.
3. Mjetet financiare të parapara sipas pikës 2. të këtij vendimi, ndahen nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, kodi i programit 003 dhe barten në nr. e xhirollogarisë: 1700200100159738 - NLB Bank, të SHVK-së.

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/105

Datë: 19.08.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 gusht 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti mbi Performancën e të Hyrave dhe Shpenzimeve Buxhetore për periudhën janar korrik 2016.
2. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë